

# PROJEKTI EU4Rivers

Forcimi i zbatimit të Reformës Kombëtare të Ujit dhe progresit të Shqipërisë drejt përmbushjes së kërkesave ligjore të BE-së për ujin.

Membështetjen e Bashkimit Evropian (BE) dhe Austria për Partneritete Ndërkombëtare, ky projekt synon përmirësimin e nivelit të saktësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave dhe informacionit, forcimin e sistemeve të monitorimit në përputhje me standardet evropiane, ndër të tjera edhe nëpërmjet investimit në pajisje për monitorimin e ujit. Do të hartohen planet e menaxhimit për basenët lumore Vjosë dhe Shkumbin si dhe do të përditësohen planet ekzistuese të baseneve të tjera. Do të krijohet Kuadri Strategjik dhe institucional për zbatimin e Direktivës Kuadër për Strategjinë Detare. Synohet nxitja e konsultimeve dhe dialogut mes grupeve të interesit dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, komunitetet lokale do të kenë akses në ujë të pastër për brezat e sotshëm dhe të ardhshëm, akses më të mirë në informacion të besueshëm dhe një zë në marrjen e masave për reduktimin e ndotjes, për mbrojtjen e biodiversitetit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së ekosistemeve lumore dhe detare ndaj ndryshimeve mjedisore, përfshirë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

Projekti EU4Rivers trajton sfidat thelbësore me të cilat po përballen lumenjtë dhe çështjet kritike që prekin mjedisin detar në Shqipëri.

Duke njohur rolin jetik që lumenjtë dhe detet luajnë në ekosisteme, në ekonominë dhe në mirëqenien e qytetarëve, ndërhyrja synon të garantojë qëndrueshmëri për brezat e ardhshëm.

**Ekosisteme të qëndrueshme dhe të shëndetshme lumore dhe detare**



**Arkitekturë funksionale e monitorimit të ujit**



**Bashkëpunim ndërkufitar**

**Agjencia Zbatuese**  
Agjencia Austriake për Zhvillim

**Kohëzgjatja**  
Tetor 2023 – Shtator 2028

**Buxheti**  
Totali: 10,39 milion euro  
 8.5 milion euro  
 1.89 milion euro

**Vendndodhja:**  
Shqipëri



## REZULTATET E PROJEKTIT

### Rezultati 1

 Kuadri gjithëpërfshirës ligjor dhe institucional për Menaxhimin e Integruar të Ujit është përmirësuar në mënyrë thelbësore në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së për ujin.

### Rezultati 2

 Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore në të gjitha basenet lumore është rritur në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit.

### Rezultati 3

 Monitorimi i ujit, raportimi dhe zbatimi janë përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në përputhje me kërkesat e acquis-së së BE-së për ujin.

### Rezultati 4

 Krijimi i kuadrit strategjik dhe institucional për Zbatimin e Direktivës Evropiane Kuadër për Strategjinë Detare (MFSF).

## AKTIVITETET KRYESORE

### Aktiviteti Kryesor 1

- Zhvillimi i udhëzuesve për zbatimin e qartë të acquis-së së BE-së për ujin;
- Zhvillimi i instrumenteve ligjore të nevojshme për të mbështetur acquis të BE-së për ujin;
- Zhvillimi i një qasjeje sistematike bazuar në ndërtimin e skenarëve dhe rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Ujit.

### Aktiviteti Kryesor 2

- Zhvillimi i planeve të menaxhimit të baseneve lumore Vjosë dhe Shkumbin;
- Përditësimi i planeve ekzistuese të menaxhimit për basenet e tjera lumore si dhe mbështetja e zbatimit të tyre;
- Lehtësimi i dialogut në nivel ndërkufitar dhe zhvillimi i nismave të përbashkëta për monitorimin e ujit.

### Aktiviteti Kryesor 3

- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi funksional për monitorimin e ujit që synon të sigurojë përputhshmërinë me acquis-në e BE-së për ujin;
- Forcimi i kapaciteteve të laboratorëve kombëtarë përmes përmirësimit të infrastrukturës së monitorimit dhe trajnimeve në përputhje me programin kombëtar të monitorimit të ujit;
- Përmirësimi i rrjetit të monitorimit, duke lehtësuar grumbullimin, vlerësimin, shkëmbimin e të dhënave, raportimin, zbatimin dhe adresimin e mangësive aktuale në politikat e ujit.

### Aktiviteti Kryesor 4

- Hartimi i një vlerësimi fillestar mbi statusin mjedisor të ujërave detare të Shqipërisë;
- Përgatitja e strategjive për menaxhimin e detit Adriatik dhe Jon;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për zhvillimin dhe zbatimin e MFSF.

## Institucionet përfituese:

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Instituti i Gjeoshkencave
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Instituti i Shëndetit Publik

## Kontakt

 Rr. Pjeter Budi, P. Klasik  
Shk.1, Ap.11, Tirana  
 +355 (0) 4 450 3200  
 [eu4rivers@ada.gov.at](mailto:eu4rivers@ada.gov.at)

**#SaveRiversSaveSeas**